VENDIM
Nr. 250, datë 24.4.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 3 dhe 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik.
2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano